

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Përmbajtja

| | Faqe |
|--|-------------|
| RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR | i-ii |
| PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA | |
| BILANCI KONTABËL I KONSOLIDUAR | 1 |
| PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE | 2 |
| PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT AKSIONAR | 3 |
| PASQYRA E KONSOLIDUAR E RRJEDHËS SË PARASË | 4 |
| SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA | 5-38 |



Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Për Aksionarët dhe Bordin Drejtues të Banka Kombetare Tregtare Sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Banka Kombetare Tregtare sh.a' ("Banka"), të cilat përfshijnë bilancin kontabël të konsoliduar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve të kapitalit aksionar dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me nenin 47 të Ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr 9662, datë 18 dhjetor 2006) dhe me Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare e miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me nenin 47 të Ligjit për Bankat në Republikën e Shqipërisë (Ligji Nr 9662, datë 18 dhjetor 2006), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me informacionin financiar të entiteteve apo aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Mediana Kodra, FCCA

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
20 mars 2019



Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**Bilanci Kontabël i konsoliduar më 31 dhjetor 2018***(shprehur në 000'LEK)*

| Aktivitet | Shënime | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|---|----------------|------------------------|------------------------|
| Aktivitet | | | |
| Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore | 4 | 36,535,915 | 32,787,793 |
| Depozita dhe llogaritë me bankat | 5 | 70,981,232 | 32,650,916 |
| Hua dhe paradhënie për bankat | 6 | 21,130,864 | 47,187,295 |
| Bono thesari | 7 | 19,549,584 | 23,276,634 |
| Letra me vlerë | 8 | 137,113,919 | 127,507,259 |
| Hua dhe paradhënie për klientët | 9 | 131,046,970 | 127,923,314 |
| Investime në pjesëmarrje | 10 | 148,055 | 159,487 |
| Aktive të qëndrueshme | 11 | 4,825,193 | 4,664,647 |
| Aktive të tjera | 12 | 6,177,345 | 6,623,688 |
| Totali i Aktiveve | | 427,509,077 | 402,781,033 |
| Detyrimet dhe Kapitali Aksionar | | | |
| Detyrimet | | | |
| Detyrime ndaj klientëve | 13 | 337,449,629 | 318,623,618 |
| Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare | 14 | 34,501,384 | 32,521,221 |
| Detyrime të tjera | 15 | 11,089,310 | 9,960,720 |
| Borxhi i varur | 16 | 3,092,121 | 3,331,833 |
| Totali i Detyrimeve | | 386,132,444 | 364,437,392 |
| Kapitali Aksionar | | | |
| Kapitali i paguar | | 33,727,923 | 30,899,018 |
| Rezerva e rivlerësimit | 17 | (1,381,923) | (418,699) |
| Fitimi i pashpërndarë | 18 | 9,030,633 | 7,863,322 |
| Totali i Kapitalit Aksionar | | 41,376,633 | 38,343,641 |
| Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar | | 427,509,077 | 402,781,033 |

Bilanci i konsoliduar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 5 deri në 38, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 05 shkurt 2019 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Seyhan Pencabligil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Këshillit Drejtues



Skënder Emmini
Drejtor i Grupit të Financës

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000'LEK)

| | Shënime | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017 |
|---|---------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Interesi | | | |
| Të ardhura nga interesi | 19 | 16,717,231 | 16,044,250 |
| Shpenzime interesi | 20 | (2,976,475) | (3,240,998) |
| Të ardhura nga interesi, neto | | 13,740,756 | 12,803,252 |
| Të ardhura të tjera nga veprimtaria bankare, neto | | | |
| Tarifa dhe komisione, neto | 21 | 2,269,640 | 2,556,892 |
| Rivlerësimi i valutave, neto | 22 | (297,106) | (1,114,419) |
| Këmbimet valutore, neto | | (513,782) | 43,667 |
| Tregtimi i letrave me vlere, neto | 23 | 342,613 | 445,306 |
| (Shpenzime)/Të ardhura të tjera neto | 24 | (1,679,654) | (822,105) |
| Totali i të ardhurave të tjera nga veprimtaria bankare, neto | | 121,711 | 1,109,341 |
| Shpenzime operative | | | |
| Shpenzime personeli | 25 | (2,127,559) | (2,138,995) |
| Shpenzime administrative | 26 | (3,434,372) | (3,276,862) |
| Amortizimi për mjete të qëndrueshme | 11 | (504,077) | (457,187) |
| Totali i shpenzimeve operative | | (6,066,008) | (5,873,044) |
| Provizjone për humbjet nga huatë | 9 | 1,842,364 | 491,107 |
| Provizjion statistikor | 15 | 291 | (117,361) |
| Provizjone të letrave me vlerë të investimit dhe huave dhënë bankave | 15 | (919,458) | - |
| Fitimi para tatimit | | 8,719,656 | 8,413,295 |
| Tatimi mbi fitimin | 34 | (1,292,477) | (1,393,781) |
| Fitimi neto i vitit | | 7,427,179 | 7,019,514 |

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 5 deri në 38, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të kapitalit aksionar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000'LEK)

| | Kapitali Aksionar | Rezerva Ligjore | Rezerva e rivlerësimit | Fitimi i pashpërndarë | Totali |
|---|------------------------------|----------------------------|-----------------------------------|----------------------------------|-------------------|
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 27,840,620 | - | 4,201,880 | 7,684,663 | 39,727,163 |
| Rritja e kapitalit aksionar | 3,058,398 | - | - | (3,058,398) | - |
| Fitimi neto i vitit | - | - | - | 7,019,514 | 7,019,514 |
| Pagesë dividendi | - | - | - | (3,768,000) | (3,768,000) |
| Fitimi i pashpërndarë nga operacionet e huaja, i rregulluar me kursin e fundit të vitit | - | - | - | (14,457) | (14,457) |
| Lëvizje në rezervën e rivlerësimit | - | - | (4,620,579) | - | (4,620,579) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2017 | 30,899,018 | - | (418,699) | 7,863,322 | 38,343,641 |
| Krijimi i rezervës ligjore | - | 1,754,879 | - | (1,754,879) | - |
| Rritja e kapitalit aksionar | 2,828,905 | (1,754,879) | - | (1,074,026) | - |
| Fitimi neto i vitit | - | - | - | 7,427,179 | 7,427,179 |
| Pagesë dividendi | - | - | - | (3,308,700) | (3,308,700) |
| Fitimi i pashpërndarë nga operacionet e huaja, i rregulluar me kursin e fundit të vitit | - | - | - | (122,263) | (122,263) |
| Lëvizje në rezervën e rivlerësimit | - | - | (963,224) | - | (963,224) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | 33,727,923 | - | (1,381,923) | 9,030,633 | 41,376,633 |

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të kapitalit aksionar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 5 deri në 38, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK)

| | Shënime | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018 | Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017 |
|--|----------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet operacionale | | | |
| Fitimi para tatimit | | 8,719,656 | 8,413,295 |
| Rregullime për të rakorduar ndryshimet në aktivet neto me flukset neto të parasë nga aktivitetet operacionale: | | | |
| Shpenzime interesi | 20 | 2,976,475 | 3,240,998 |
| Të ardhura nga interesi | 19 | (16,717,231) | (16,044,250) |
| Amortizimi për mjetet e qëndrueshme | 11 | 504,077 | 457,187 |
| Fitimi nga shitja e mjeteve të trupëzuara | | (3,806) | (1,652) |
| Fitimi nga shitja e letrave me vlerë | | (334,658) | (434,355) |
| Fitimi nga shitja e bonove të thesarit | | (7,955) | (10,950) |
| Fitimi nga shitja e aktiveve të përfituara nga procesi ligjor | | (19,966) | (15,224) |
| Fitimi nga rimarrja e kredive të humbura | | (82,017) | (61,582) |
| Nxjerrje jashtë përdorimit e mjeteve të qëndrueshme | | 1,106 | 2,393 |
| Humbje nga kreditë e pakthyeshme | | 1,242,472 | 764,237 |
| Nxjerrje jashtë përdorimit e mjeteve të qëndrueshme dhe mjeteve të riposduara | | 10,335 | 664 |
| Provizjone të letrave me vlerë të investimit dhe huave dhënë bankave | | 919,458 | - |
| Provizjone të aktiveve të përfituara nga procesi ligjor | | 504,038 | 298,011 |
| Provizjone për debitorë të tjerë | | - | 161,590 |
| Pakësimi i fondit të provigjoneve për aktive të përfituara nga procesi ligjor | | (24,061) | (8,144) |
| Lëvizje në rezervën e rivlerësimit | 17 | (963,224) | (4,620,579) |
| Provizjone për humbjet nga huatë | 9,15 | (1,842,655) | (373,746) |
| | | (5,117,956) | (8,232,107) |
| (Rritja)/ Pakësimi i aktiveve operacionale: | | | |
| Depozita dhe llogaritë me bankat | | (38,342,004) | (9,184,669) |
| Hua dhe paradhënie për bankat | | 25,946,086 | (1,617,255) |
| Hua dhe paradhënie për klientët | | (2,531,436) | (1,556,897) |
| Aktive të tjera | | (13,668) | (1,933,195) |
| | | (14,941,022) | (14,292,016) |
| Rritja/(Pakësimi) i detyrimeve operacionale: | | | |
| Detyrime ndaj klientëve | | 18,879,555 | 17,816,035 |
| Detyrime të tjera | | 321,089 | 36,398 |
| | | 19,200,644 | 17,852,433 |
| Pagesë dividendi, neto | | (3,308,700) | (3,768,000) |
| Interesi i paguar | | (3,028,687) | (3,384,154) |
| Interesi i arkëtuar | | 16,525,716 | 15,684,961 |
| Tatim fitimi i paguar | | (1,404,144) | (1,412,009) |
| Paraja neto nga aktivitetet operacionale | | 7,925,851 | 2,449,108 |
| Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese | | | |
| Blerje e letrave me vlerë | | (31,859,453) | (33,186,729) |
| Blerje e bonove të thesarit | | 263,973 | (8,038,314) |
| Investime në filiale | | 11,432 | 2,735 |
| Blerje e mjeteve të trupëzuara | | (672,034) | (2,481,951) |
| Hyrje nga shitja e mjeteve të trupëzuara | | 10,111 | 1,384 |
| Hyrje nga shitja e bonove të thesarit | | 3,426,926 | 4,289,808 |
| Hyrje nga shitja e letrave me vlere | | 23,034,794 | 35,960,189 |
| Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese | | (5,784,251) | (3,452,878) |
| Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese | | | |
| Hyrje nga detyrimet afatshkurtra | | 1,977,369 | 3,236,655 |
| Borxhi i varur | | (246,332) | (65,223) |
| Paraja neto nga aktivitetet financuese | | 1,731,037 | 3,171,432 |
| Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj | | 3,872,637 | 2,167,662 |
| Diferencat në kursin e këmbimit | | (124,515) | (6,900) |
| Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore: | | | |
| Në fillim të vitit | 4 | 32,787,793 | 30,627,031 |
| Në fund të vitit | 4 | 36,535,915 | 32,787,793 |

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faja 5 deri në 38, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë si dhe pjesëmarrjen në Albania Leasing sh.a. (referuar së bashku në vazhdim si “Banka”, “BKT” ose “Grupi”).

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron: një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV, bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur më 30 nëntor 1925. BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 “Mbi Bankën e Shqipërisë” në dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006.

Në datën 27 Mars 2018, me Vendim të Aksionerëve, Banka krijoi rezervën ligjore në vlerën 1,754,878 mijë Lek. Pjesa e mbetur e fitimit të vitit 2017 në vlerën 5,264,635 mijë Lek u mbajt si fitim i pashpërndarë.

Në bazë të Vendimit të Aksionerëve të marrë në datën 13 gusht 2018, Banka rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 2,828,905 mijë Lek (ekuivalente e 25,649,690.3 USD) dhe pagoi dividend në shumën 3,308,700 mijë Lek (ekuivalente e 30,000,000 USD), duke përdorur rezervën ligjore prej 1,754,879 mijë Lek (ekuivalente e 15,911,491.92 USD) si edhe një pjesë të fitimit të saj neto të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe një pjesë të fitimit të pashpërndarë prej 1,074,026 mijë Lek (ekuivalente e 9,738,198.38 USD). Rritja e kapitalit dhe pagesa e dividendit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datën 13 gusht 2018 (110.29 Lek për USD).

Në vijim të kësaj rritje, struktura aksionare mbeti e njëjtë, me vlerë nominale të aksioneve 12.35 USD, ndërsa numri i aksioneve u rrit me 2,076,898 aksione. Struktura aksionare më datë 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2018 | | | 31 dhjetor 2017 | | |
|-------------------------------|-----------------|---------------|-----|-----------------|-------------|-----|
| | Nr. i aksioneve | Totali USD | % | Nr. i aksioneve | Totali USD | % |
| Calik Finansal Hizmetler A.S. | 24,291,498 | 300,000,000.3 | 100 | 22,214,600 | 274,350,310 | 100 |

Drejtorja e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 65 degësh dhe 2 agjencish doganore. Njëzet e gjashtë prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Vlora, Shkodra, Fier, Pogradec, Korca, Bilisht, Gjirokastra, Delvina, Saranda, Orikum, Berat, Kucova, Lushnja, Librazhd, Peqin, Rrogozhina, Shkozë, Kavaja, Vora, Kamza, Fushe Kruja, Lac, Lezha, Rreshen, Kukes, Peshkopi, Bushat, Koplik, Gramsh dhe Skrapar, të ndjekura nga agjencitë doganore në Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit.

Rrjeti në Kosovë përfshin 26 njësi. Shtatë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Peja, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovica, Gjakova, Vushtrri, Fushe Kosova, Podujeva, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Dheu i Bardhe, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Banka kishte 1,292 punonjës (31 dhjetor 2017: 1,292) në datën 31 dhjetor 2018, nga të cilët 358 (31 dhjetor 2017: 348) i përkasin BKT Kosovës.

2. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara shoqëruese janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”), e miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” (“Ligji për Bankat”).

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e parimeve kontabël

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë të shprehura në Lek, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shënuar ndryshe dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç se për letrat me vlerë të vendosjes, të cilat llogariten me vlerën e tregut.

Parimet kontabël të zbatuara nga Banka, janë të njëjta me ato të përdorura në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

3.2 Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësia, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë.

Konsolidimi i një filiali fillon nga momenti kur Banka merr kontrollin mbi filialin dhe ndalon kur Banka humb kontrollin e filialit. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali, të blerë apo shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve nga data kur Banka mer kontrollin deri në datën kur Banka humbet kontrollin mbi njësinë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël të njëjta për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më 3 shtator 2007. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në Prishtinë, Kosovë. Banka Qendrore e Kosovës aprovoi më 30 prill 2018 transformimin në filial të Degës së Kosovës të Bankës Kombëtare Tregtare. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Dega e BKT – së në Kosovë do të mbeten të drejta dhe detyrime të BKT Kosova Sh.A si një filial. Data e shkëputjes së BKT Kosovës është efektive nga data 1 janar 2019.

(ii) Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Të gjitha aktivet dhe detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedhjet e parasë (përveç fitimeve dhe humbjeve nga transaksionet në monedhë të huaj) të lidhura me transaksionet ndërmjet anëtarëve të Grupit janë eliminuar plotësisht në konsolidim. Humbjet e perealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e perealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për humbje të vlerës.

3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë kthyer me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe detyrimet monetare, të shprehura në monedhë të huaj, të cilat kontabilizohen me koston historike në datën e transaksionit, janë këmbyer sipas kursit të këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare, të shprehura në monedhë të huaj, në vlerën e tyre historike, rivlerësohen me kursin e këmbimit në datën kur është bërë transaksioni. Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave të aktiveve e detyrimeve monetare janë njohur në pasqyrën e të ardhurave tek "Fitimi (humbja) nga rivlerësimi i valutave, neto".

Kapitali i paguar është trajtuar si një zë monetar dhe është rivlerësuar në përputhje me parimin e shpjeguar më sipër. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, kapitali në monedhë të huaj duhet të paraqitet në bilanc i konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit dhe një "rezervë rivlerësimi" e krijuar në kapitalin e aksionarëve që përfaqëson diferencën në Lek ndërmjet kursit të fundit të periudhës me kursin historik që përdoret për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj.

3.4 Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore mbahen në bilancin kontabël të konsoliduar me kosto të amortizuar.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e parimeve kontabël (vazhdim)

3.5 Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndërbankare dhe zëra që janë në procesin e arkëtimit.

3.6 Bonot e thesarit

Bonot e thesarit janë klasifikuar në dy kategori si aktive të vendosjes ose deri në maturim dhe regjistrohen fillimisht me kosto plus interesin e përlllogaritur. Bonot e thesarit janë klasifikuar duke u bazuar në qëllimin dhe aftësinë e Bankës për t'i mbajtur deri në maturitet.

3.7 Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje. Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në çmimin e tregut, me interesin e përlllogaritur për kuponat për t'u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e transferimit përlllogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë. Letrat me vlerë të vendosjes, pas regjistrimit të tyre fillestar rimaten me vlerën e tregut dhe humbjet që shkaktohen nga ndryshimi i vlerës së tregut të letrave të vendosjes përfshihen tek fitimi dhe humbja neto për periudhën përkatëse. Këto letra me vlerë konsiderohen si të vendosjes pasi Banka ka si qëllim shitjen e tyre përpara datës së maturimit.

3.8 Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me interesin e përlllogaritur për kuponat për t'u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përlllogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë.

3.9 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë. Provigjionet krijohen në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" (Rregullorja e kredisë) e miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës datë 14 shtator 2011. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë huatë e saj në gjashtë kategori rreziku. Për çdo kategori rreziku, janë zbatuar normat e mëposhtme të provigjioneve:

| <i>Lloji i huasë</i> | <i>Ditë vonese për overdraftet</i> | <i>Ditë vonese për huatë me afat</i> | <i>Norma e provigjionit</i> |
|----------------------|------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| Standarde | 0 ditë | 0 ditë | 1% |
| E pakthyer në afat | 1-30 ditë | 1-30 ditë | 1% |
| Në ndjekje | 31-60 ditë | 31-90 ditë | 5% |
| Nënstandarde | 61-90 ditë | 91-180 ditë | 20% |
| E dyshimtë | 91-180 ditë | 181-365 ditë | 50% |
| E humbur | Over 180 ditë | Over 365 ditë | 100% |

Provigjionet për humbje nga huatë për BKT Kosovën janë krijuar në bazë të Rregullës "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" (e ndryshuar), miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës më 26 April 2013. Normat minimale të provigjionit të aplikuara nga dega për çdo kategori janë të njëjta me ato të aplikuara në Shqipëri.

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë e klasifikuara si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Provigjionet e krijuara për humbje të mundshme nga huatë e klasifikuara si standarde, të pakthyer në afat dhe në ndjekje janë regjistruar si provigjione statistikore në anën e detyrimeve të bilancit. Për informacion të detajuar mbi huatë dhe paradhëniet për klientët referojuni shënimeve 9 dhe 15.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e parimeve kontabël (vazhdim)

3.10 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar.

Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhjet e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

3.11 Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet rrjedhin nga shërbimet financiare që ofrohen nga Banka, si transferime fondesh, mbajtjen e llogarive, aktivitetet e huadhënies dhe të tregtimit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisionet dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

3.12 Tatimi mbi fitimin

Banka përcakton shumën e tatueshme në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar të tatimeve. Në vitin 2018, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% të fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke modifikuar fitimin para tatimit për zëra të caktuar të ardhurash dhe shpenzimesh në përputhje me legjislacionin shqiptar. Fitimi përpara tatimit bazohet mbi regjistrimet financiare të mbajtura nga Banka për qëllime rregullatore në përputhje me MRF dhe mund të ndryshojë nga rezultati financiar i raportuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Shiko shënimin 34. Megjithatë, tatimi mbi fitimin për t'u paguar për vitin e mbyllur financiar 2018 rezultoi i njëjti sipas të dy standardeve. Për arsye se, në ndryshim me SNRF, MRF nuk kërkon që Banka të masë dhe të regjistrojë aktivet dhe detyrimet e shtyra, tatimi mbi fitimin i shtyre nuk mund të paraqitet në keto pasqyra financiare.

Në përcaktimin e shumës së tatimit të vitit Banka merr në konsideratë efektin e disa pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse do ketë detyrime për tatime apo interesa shtesë. Banka beson se shpenzimet e saj të përlllogaritura për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore duke e bazuar vlerësimin e saj në shumë faktorë, përfshirë dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë disa gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të ditura, mund të bëjnë që Banka të ndryshojë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën që bëhet përcaktimi.

3.13 Plani i pensionit

Banka ka krijuar një fond për planin e pensionit (Programi Mbështetës për Stafin – 'SSP') i sponsorizuar tërësisht nga punëdhënësi (shiko shënimin 15 "Fondi rezervë për pensionin e punonjësve") në vitin 2002. Shuma që do të regjistrohej tek ky fond vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit. Gjatë vitit, shumën e përlllogaritur regjistrohej tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve tek fondi në bazë mujore.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e parimeve kontabël (vazhdim)

3.13 Plani i pensionit (vazhdim)

Shumat që Banka i detyrohet punonjësve në bazë të planit të mësipërm do të rriten me të ardhura bruto nga interesi nga data që punonjësi largohet nga Banka deri në momentin e daljes në pension. Shumat do t'u paguhet punonjësve vetëm kur ata arrijnë moshën e pensionit sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me një minimum prej 75% të pensionit të tyre shtetëror mujor derisa fondi i akumuluar për punonjësit konsumohet. Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues, të hyrë në fuqi më 30 shtator 2010, Banka ka ndërprerë investimin në fondin SSP, duke e transformuar atë në Programin e Kreditimit të Qëndrueshmërisë së Stafit ('SRCP'). Shuma e llogaritur për secilin punonjës përfitues nga SSP u ngurtësua në të njëjtën ditë. Shuma e ngurtësuar dhe interesi përkatës vjetor që do të gjenerohet nga investimi në të ardhmen në letra me vlerë të klasifikuara AAA deri në daljen në pension të punonjësit, do t'i shtohet fondit të investimit nga ana e Bankës.

3.14 Aktive të qëndrueshme dhe rregullim i ambienteve me qira

Pronat dhe pajisjet janë të shprehura me kosto minus amortizimin e akumuluar, i cili është llogaritur me mënyrën lineare mbi jetën e përdorimit të vlerësuar për këto aktive.

Toka nuk amortizohet.

Amortizimi është llogaritur në përputhje me normat e mëposhtme:

| | |
|--|-----|
| Ndërtesa dhe rregullimi i ambienteve me qira | 5% |
| Mjete transporti | 20% |
| Pajisje dhe mobilim zyre | 20% |
| Pajisje TI dhe elektronike | 25% |
| Pajisje | 20% |

3.15 Veprimet spot të këmbimit valutor

Banka gjatë aktivitetit normal të punës kryen veprime spot të këmbimit valutor, me data shlyerje pas një ose dy ditësh pas datës së transaksionit. Këto transaksione regjistrohen tek zërat jashtë bilancit në datën e transaksionit dhe njihen në datën e shlyerjes së transaksionit.

4. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore

Gjendjet e arkës dhe llogaritë me Bankën Qendrore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|--|-------------------|-------------------|
| Arka | 6,846,585 | 4,806,391 |
| Depozita me Bankën Qendrore të Kosovës | 3,861,639 | 2,944,500 |
| Banka e Shqipërisë | | |
| Llogaria rrjedhëse | - | 1,903,499 |
| Rezerva e detyrueshme | 25,827,014 | 23,132,420 |
| Interesi i përlllogaritur | 677 | 983 |
| Totali | 36,535,915 | 32,787,793 |

Në përputhje me kërkesën e Bankës së Shqipërisë në lidhje me rezervën e detyrueshme për depozitat, Banka duhet të mbajë një minimum në masën 10% të depozitave të klientëve në Shqipëri pranë Bankës së Shqipërisë, si llogari të rezervës së detyrueshme, e cila gjatë muajit mund të përdoret deri në 70% të nivelit të saj, me kushtin që të ruhet mesatarja mujore.

Depozitat me Bankën Qendrore në Kosovë përfshijnë minimumin e kërkuar të rezervës së detyrueshme në masën 10% të depozitave të klientëve në Kosovë dhe depozitën minimale në para të bllokuar si depozitë ekuivalente me kapitalin.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozita dhe llogaritë me bankat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen nga sa vijon:

| | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|--|-------------------|-------------------|
| Depozitat | 38,039,036 | 24,372,517 |
| Garanci në para mbajtur nga institucionet financiare | 1,330,354 | 591,238 |
| Llogaritë rrjedhëse | 31,570,608 | 7,634,545 |
| Interesi i përlllogaritur | 41,234 | 52,616 |
| Totali | 70,981,232 | 32,650,916 |

Depozitat janë vendosur në bankat jo-rezidente nga vendet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OZhBE) dhe kanë maturime kontraktuale deri në 1 vit. Llogaritë rrjedhëse paraqesin gjendjet me bankat korrespondente në vendet e OZhBE-së.

Garancia në para përfaqëson kolateralin e mbajtur nga bankat korrespondente përkundrejt letër kredive të lëshuara për klientët e Bankës nga bankat korrespondente, si dhe depozitën në para për garantimin e rreziqeve, të cilat mund të shfaqen nga aktiviteti i Bankës lidhur me kartat e kreditit.

6. Hua dhe paradhënie për bankat

Banka ka marrë pjesë në kredi sindikale me banka jo-rezidente me klasifikime si vijon:

| Moody's or equivalent | 31 dhjetor 2018 | | | 31 dhjetor 2017 | | |
|-----------------------|-------------------|---------------|-------------------|-------------------|----------------|-------------------|
| | Principal | Interes | Total | Principal | Interes | Total |
| Baa3 deri Baa1 | 2,259,870 | 11,218 | 2,271,088 | 3,524,100 | 13,698 | 3,537,798 |
| Ba3 deri Ba1 | 12,942,120 | 26,700 | 12,968,820 | 33,122,998 | 88,975 | 33,211,973 |
| B2 deri B1 | 3,777,840 | 10,501 | 3,788,341 | 2,352,175 | 7,691 | 2,359,866 |
| Caa3 deri Caa1 | - | - | - | 1,111,000 | 3,442 | 1,114,442 |
| Të paklasifikuara | 2,096,760 | 5,855 | 2,102,615 | 6,912,403 | 50,813 | 6,963,216 |
| | 21,076,590 | 54,274 | 21,130,864 | 47,022,676 | 164,619 | 47,187,295 |

7. Bono thesari

Bonot e thesarit të vendosjes sipas maturimit original më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 janë të paraqitura si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2018 | | | 31 dhjetor 2017 | | |
|---------|-------------------|--------------------------|--------------------|-------------------|--------------------------|--------------------|
| | Çmimi i blerjes | Interes i përlllogaritur | Kosto e amortizuar | Çmimi i blerjes | Interes i përlllogaritur | Kosto e amortizuar |
| 6 muaj | 1,107,812 | 1,353 | 1,109,165 | 33,208 | 13 | 33,221 |
| 12 muaj | 18,172,216 | 268,203 | 18,440,419 | 22,929,765 | 313,648 | 23,243,413 |
| | 19,280,028 | 269,556 | 19,549,584 | 22,962,973 | 313,661 | 23,276,634 |

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në 000 LEK, nëse nuk është shënuar ndryshe)

8. Letra me vlerë

